

platforma

CiviKos



Buletini 9

Prill - Qershor 2016

Këshilli aprovoi planin e punës për vitin 2016

Më 4 Prill 2016 u mbajt takimi i rregullt i Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, i pari për vitin 2016.

Takimi është udhëhequr nga kryesuesi i Këshillit Zt. Fitim Krasniqi dhe bashkëkryesuesja Znj. Valdete Idrizi. Këshillit ju bashkëngjitën katër anëtarë të rinj të shoqërisë civile të zgjedhur nga votat e organizatave anëtare, Florina Duli nga organizata IKS, Feride Rushiti nga KRCT, Arton Demhasaj nga Çohu dhe Furtuna Sheremeti nga Lëvizja Fol.

Në këtë takim u aprovua Raporti i implementimit të Strategjisë për vitin 2015, si dhe plani i punës për vitin 2016, i cili plan është hartuar nga katër ekipet e punës për katër objektivat strategjike. Viti 2016 duhet të jetë vit intensiv i implementimit të strategjisë për 4 objektivat strategjike në mënyrë që në fund të vitit 2017 të kemi rezultatet konkrete të implementimit të strategjisë.

Raportet mujore të implementimit të Strategjisë do të diskutohen në takimet e rregullta të sekretarëve, ku do të adresohen të gjitha sfidat në implementim të Strategjisë. Po ashtu në këtë takim u vendos që të ketë më shumë komunikim ndër institucional për koordinimin e veprimeve rreth implementimit të Strategjisë si dhe komunikim me publikun e gjerë duke shfrytëzuar mediet në Kosovë.



Shoqëria Civile mbetet e pakënaqur - konsultimet publike ende sipërfaqësore

Platforma CiviKos me datën 7 prill 2016, në Qendrën Informativë dhe Kulturorë e BE-së, publikoi raportin mbi konsultimet publike të Qeverisë me organizata të shoqërisë civile, respektivisht me organizatat anëtare të Platformës CiviKos gjatë vitit 2015. Drejtorja Ekzekutive, e CiviKos Valdete Idrizi, e cila në fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi se mungesa e një mekanizmi dhe sistemi të mirëfilltë për konsultime publike, që adresohen edhe në raport, kanë paraqitë probleme si një numër i konsideruar i ligjeve që nuk konsultohen fare nga qeveria, po ashtu mungesa e përgjigjeve nga institucionet publike për përfshirjen apo mos përfshirjen e kontributeve nga shoqëria civile rezultojnë me një proces të varfër të konsultimeve publike me shoqërinë civile, respektivisht me organizatat anëtare të CiviKos-it, 180 sosh.

Të gjeturat e raportit u prezantuan nga Dardan Kryeziu - Zyrtar për Monitorim në CiviKos, ku u paraqiten të dhënat nga monitorimi i vazhdueshëm i procesit të konsultimit publik me qeverinë, si dhe rezultatet e hulumtimit rreth përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces për vitin 2015. Pjesëmarrësit në diskutim i kontribuan debatit për përfshirjen aktive të shoqërisë civile në konsultime publike si vlerë e demokracisë, ku u potencuan konsultimet sipërfaqësore nga disa ministri të linjës, mungesa e transparencës në këtë proces etj. Po ashtu u theksuan shembujt pozitiv të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile qysh në fazat më të hershme të konsultimit.

138 projektligje kanë qenë të parapara me agjendë legjislative për vitin 2015. Prej gjithsejt 80 projektligjeve sa janë miratuar në qeveri, vetëm 21 prej këtyre janë konsultuar me CiviKos përkundër zotimit për të kundertën.

Aprovimi i rregullores së re që do të aprovohet së shpejti, respektivisht standardeve minimale për konsultime publike, e cila është hartuar nga Zyra Ligjore e Kryeministrit, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, në kuadër të objektivës së parë të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, do të mundësojë vendosjen e një sistemi gjithëpërfshirës për konsultimin publik. Për më shumë lexoni raportin duke klikuar në linkun: <http://civikos.net/sq/publikimet-e-civikos>

Procesi i përzgjedhjes së një përfaqësuesi të shoqërisë civile në grupin punues të Ministrisë së Financave për hartimin e Projekt rregullores për urdhërimet zyrtre

Pas përfundimit të fazës së nominimit dhe procesit të votimit, sekretariati i Platformës CiviKos, si bartëse e procesit për organizimin e zgjedhjeve për një anëtar të shoqërisë civile në grup punues të Ministrisë së Financave me datë 13.05.2016 në zyrat e CiviKos organizoi numërimin e votave.

Pas verifikimit të votuesve u numëruan të gjitha votat ku gjithsej ishin 10 vota, të gjitha të vlefshme. Pas numërimit si përfaqësues i shoqërisë civile në grupin punues, me shumicë votash, u përzgjedh Florent Spahija nga KDI/TIK (Instituti Demokratik i Kosovës/Transparency International Kosova).



Bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale

Gjatë maj 2016 Sekretariati e CiviKos së bashku me Qendrat Rajonale nga 5 Rajoneve organizuar takime me organizatat lokale të shoqërisë civile. Qëllimi i kësaj serie të takimeve ishte për të analizuar situatën e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale në 5 regjione të Kosovës, si dhe nevojat e organizatave të shoqërisë civile për forcimin e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale. Pas këtyre konsultimeve, Sekretariati i CiviKos së bashku me 5 Qendrat rajonale do të hartojë Strategjinë e përbashkët të Qendrave Rajonale të CiviKos.

Këto takime janë mbajtur në:

- 16.05.2016 - Takimi me organizatat e shoqërisë civile në Mitrovicë
- 19.05.2016 - Takimi me organizatat e shoqërisë civile në Gjilan
- 25.05.2016 - Takimi me organizatat e shoqërisë civile në Pejë
- 26.05.2016 - Takimi me organizatat e shoqërisë civile në Ferizaj dhe Prizren

Pas këtyre takimeve, Platforma CiviKos ka organizuar punëtorinë dy ditore për hartimin e Planifikimit strategjik për Qendrat rajonale



Aktivitet tjera të Platformës CiviKos

Platforma CiviKos gjatë këtij tre mujorshi ka marrur pjesë në mbi 70 aktivitete dhe ngjarje të ndryshme duke dhënë kontributin e saj qoftë si pjesëmarrës në panel diskutimi apo duke dhënë kontribut në takime.

Sekretariati i CiviKos takohet rregullisht me anëtarët e këshillit për t'i informuar ata për aktivitetet e strategjisë dhe për të lehtësuar veprimtarinë e këshillit të komunikimit me qeverinë. Aktivitetet në pika të shkurtëra:

- 03.05.2016 - Me kërkesë të Sekretariatit të CiviKos, ZQM organizoi takimin me grupin e punës për Objektivin II të Strategjisë Qeveritare në zyrat e ZQM-së. Anëtarja e re e zgjedhur në këshill, Florina Duli është zgjedhur si koordinatore e këtij grupi punues. Në këtë takim u diskutua për progresin e kësaj objektiviteti dhe disa veprime konkrete për muajt e ardhshëm.
- 17.05.2016 - Sekretariatit të Platformës CiviKos, së bashku me koordinatoren e grupit të punës për Objektivën II, të Strategjisë, Florina Duli hartuan një kërkesë për të gjitha ministritë për të publikuar listën e OJQ-ve të kontraktuara nga ministritë, dhe listën e granteve për tri vitet e fundit. Ky aktivitet është i planifikuar me planin e punës për zbatimin e Strategjisë për vitin 2016.
- 30.05.2016 - Zyra për Qeverisje të Mirë - ZQM, së bashku me Sekretariatit të CiviKos kanë organizuar takim me grupin e punës, të objektivitetit nr IV respektivisht koordinimin e aktiviteteve për vullnetarizmin.
- 31.05.2016 - Zyra për Qeverisje të Mirë - ZQM, së bashku me Sekretariatit të CiviKos kanë organizuar takim me grupin e punës, të Objektivën III, për të diskutuar për të organizuar aktivitete të përbashkëta të planifikuara në planin e punës 2016.
- 02.06.2016- Sekretariati i Zyrës për Qeverisje të mire - ZQM së bashku me sekretariatit të CiviKos kanë organizuar takimin e grupit të punës për Objektivën I, për të diskutuar rreth promovimit të rregullores për standarde minimale.
- Sekretariati i CiviKos në vazhdimësi ka shpërndarë dhe publikuar lajme rreth aktiviteteve, e-newsletter, dhe përditësime në faqen e internetit dhe mediave sociale, duke nxitur procesin e dialogut në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë. Poashtu është promovuar Rregullorja e re e standardeve minimale për konsultime publike.